



Cfare janë të drejtat tuaja në rast të ndërprerjes së marrëdhënies së punës?

Kur marrëdhënia e punës me punëdhënësin tuaj prishet sepse ligji ia ndalon atij të ju punësojë, ju keni të drejtë për:

Nëse jeni i/e deklaruar



- ✓ Të gjithë pagën tuaj dhe shtesat e saj (bonuse, përfitime në natyrë dhe pushime të paguara, etj.);
- ✓ Dëmshpërblimin fiks për ndërprerjen e marrëdhënies së punës që korrespondon me 3 muaj pagë.

Nëse nuk jeni deklaruar



- ✓ Të gjithë pagën tuaj dhe shtesat e saj (bonuse, përfitime në natyrë dhe pushime të paguara, etj.);
- ✓ Dëmshpërblimin fiks për ndërprerjen e marrëdhënies së punës që korrespondon me 6 muaj pagë, nëse punëdhënësi juaj e ka fshehur qëllimisht punësimin tuaj;

OSE

- ✓ Pagesën e 3 muajve pagë + 3 muaj dëmshpërblim fiks për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, nëse punëdhënësi nuk mund të provojë datën reale të punësimit.

Ju mund të kërkonti një dëmshpërblim shtesë pranë Këshillit të pajtimit të punës (Conseil des prud'hommes) nëse vlerësoni se keni pësuar një dëm që nuk është shpërblyer.



Kontakte të dobishme


- ✓ Zyra Franceze për Imigrimin dhe Integrimin (OFII)

- ✓ Inspektimet e Punës (DDETS dhe DREETS)

Koordinatat e kontaktit ndryshojnë sipas departamentit ku punoni.

- ✓ Shoqatat që mund t'ju ndihmojnë:

- CIMADE
- NDJEHESË POPULLORE
- FORUMI I REFUGJATËVE
- LIDHJA PËR TË DREJTAT E NJERIUT
- KOMITETI KUNDËR SKLLAVËRISË MODERNE



Shihni shoqatat dhe inspektimet e punës për t'i kontaktuar në departamentin tuaj



MINISTÈRE
DU TRAVAIL, DE LA SANTÉ
DES SOLIDARITÉS
ET DES FAMILLES

Direction régionale
de l'économie, de l'emploi,
du travail et des solidarités
Auvergne-Rhône-Alpes

PUNËTORËT E HUJT

(Iashtë BE-së, EEE-së dhe Konfederatës Zvicerane)

TË DREJTAT TUAJ

Në Francë,
pavarësisht nga situata juaj,
keni të drejta!





Cilat janë të drejtat tuaja si punëtor?

- ☒ Ju nuk duhet të paguani asnjë shumë parash për të marrë një kontratë pune ose për të punuar.
- ☒ Duhet të paguheni çdo muaj.
- ☒ Nuk mund të punoni më shumë se 10 orë në ditë (përveç rasteve të veçanta).
- ☒ Nuk mund të punoni më shumë se 6 ditë në javë.
- ☒ Punëdhënësi juaj nuk mund të mbajë një pjesë të pagës suaj për një shërbim të ofruar ose për një gabim.
- ☒ Të kesh një kontratë të shkruar ju mbron.
- ☒ Paga juaj jepet në bazë të orëve të punës së kryer dhe jo sipas detyrës së realizuar.
- ☒ Punëdhënësi juaj duhet t'ju japë një listë pagese çdo muaj.
- ☒ Kur punoni, keni të drejtë për pushime dhe leje të paguar.



Punë e padeklaruar është ajo që nuk është bërë objekt i një deklarate paraprake të punësimit (DPAE) te Urssaf ose MSA. Ose kur punonjësi nuk ka fletëpagëse ose ato përmbajnë të dhëna të rreme ose të pasakta.



Si të realizoni të drejtat tuaja të fituara nga puna?

1. Nëse nuk jeni i/e privuar nga liria apo nga lëvizja gjatë ndërprerjes së marrëdhënies së punës:

Nëse punëdhënësi juaj ose porositiçi nuk ju paguan shumën e detyruar brenda 30 ditëve, mund të paraqisni kërkesë pranë Këshillit të pajtimit të punës (Conseil de prud'hommes) nëpërmjet:

- ☒ Një avokati
- ☒ Një organizatë sindikale
- ☒ Drejtpërdrejt nga vetë punonjësi

<https://www.service-public.fr/particuliers/vosdroits/F2360>



2. Nëse jeni i/e vendosur në arrest shtëpie ose në një qendër të ndalimit administrativ (CRA) :



OFII mund të ndërhyjë për ju. Duhet t'i tregoni agjentit të OFII se nuk keni marrë pagën dhe shpërblimet tuaja.

OFII do të kujdeset për t'i marrë ato për ju.

<https://www.ofii.fr/>



** Edhe në rast kthimi vullnetar ose të detyruar.*



Kush i paguan të drejtat tuaja të fituara nga puna?

Punëdhënësi duhet të paguajë pagën dhe shpërblimin tuaj brenda 30 ditëve nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Ai gjithashtu duhet t'ju dorëzojë dokumentet që lidhen me periudhën tuaj të punës (listë pagese dhe certifikatë pune).

Në disa raste, ligji ju lejon të kërkonit shumën e papaguar jo nga punëdhënësi, por nga porositiçi ose klienti.



Nëse keni përjetuar kushte abuzive pune, keni qenë viktimë e trajtimeve çnjerëzore ose degraduese, ose nëse punëdhënësi ju ka strehuar në kushte të padenja, mund të paraqisni një ankesë pranë një shërbimi të policisë ose xhandarmërisë dhe të referoni çështjen në gjykatën penale.



Në rast të këtyre shkeljeve, mund të kërkonit një leje qëndrimi të përkohshme nga prefektura, për kohëzgjatjen e procedurës ligjore.